

Metodat e mësimi të lexim-shkrimit fillestar

Hyrje në metodat e lexim-shkrimit fillestar

Dy konceptet bazë: të lexuarit fillestar dhe të shkruarit fillestar.

Të lexuarit dhe të shkruarit janë kompetencat më të rëndësishme që duhet të zhvillojë çdo fëmijë gjatë shkollimit. Ato, jo vetëm janë thelbësore për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por janë edhe kompetenca themelore për jetën. Fëmijët të cilët nuk kanë aftësi të mira leximi dhe shkrimi, në të ardhmen kanë mundësi të kufizuara ekonomike dhe zhvillimore. Të lexuarit ka rëndësi jo vetëm për individin, por edhe për ekonominë dhe shoqërinë në tërësi. Studimet tregojnë se niveli mesatar i leximit të popullsisë së një vendi është një parashikues i mirë i rritjes së tij ekonomike. Njohuritë dhe aftësitë bazë për të lexuarit dhe për të shkruarit, nxënësi i fiton gjatë arsimit fillor. Nëse në këtë cikël, nxënësi nuk fiton rrjedhshmërinë e duhur në lexim dhe shkrim, atëherë e ka shumë të vështirë që të përmbushë kërkesat e shkollës. Prandaj mësuesit e arsimit fillor, pikësëpari janë mësues të lexim- shkrimit dhe ky është roli i tyre më i rëndësishëm.



Mësimi i gjuhës shqipe është një nga objektivat parësorë në tërë arsimin e detyruar të shkollës. Gjuha shqipe fillon të mësohet në familje, vazhdon më pas në arsimin parashkollor përmes ushtrimeve të folurit dhe aftësimi të fëmijëve për të lexuar e për të shkruar dhe pasurohet më tej në arsimin fillor, me përvetësimin e aftësive të plota të të lexuarit dhe të shkruarit. Në klasën e parë në Mal të Zi fëmijët parapërgatiten për mësimin e shkronjave. Në këtë fazë zakonisht mbizotëon metoda globale, ndërsa në klasën e dytë të shkollës fillore, gjuha shqipe fillon të mësohet

në mënyrë sistematike përmes të ushtruarit për lexim-shkrimin fillestar. Nxënësit ushtrohen të lexojnë dhe të shkruajnë gjuhën shqipe përmes nyjëtimit (shqiptimit) dhe bashkimit të tingujve dhe shkronjave të saj në rrokje e fjalë dhe bashkimit të fjalëve në fjali të thjeshta, por të kuptimshme, nëpërmjet leximit të historive (rrëfimeve, copëzave, tregimeve) dhe materialeve të tjera të shkruara, të përgatitura për nxënësit në tekstet shkollore, si dhe në botime të tjera ndihmëse.

Në klasën e dytë në Mal të Zi fillon të shfaqet modeli i gjuhës së shkruar dhe drejtshkrimi i saj, fillojnë të mësohen në mënyrë intuitive nocione gjuhësore, si: tingulli, rrokja, fjala, fjalia, zanoret, bashkëtingëlloret, shenjat e pikësimit, përdorimi i shkronjës së madhe etj. Nxënësit fillojnë të dallojnë tekstin, titujt, paragrafët etj. Mësimi i lexim-shkrimit fillestar ndjek një ecuri didaktike që lidhet me respektimin e tri fazave:

Faza e parë, lidhet me periudhën përgatitore për lexim-shkrimin (e cila shtrihet gjatë gjithë klasës së parë);

Faza e dytë, lidhet me fitimin e shprehive elementare të teknikës së lexim-shkrimit (shtrihet gjatë klasës së dytë);

Faza e tretë lidhet me përfundimin e teknikës së lexim-shkrimit (në fund të klasës së dytë e në vazhdim).

Synimet kryesore të mësimi të gjuhës amtare në shkollë janë zhvillimi i aftësive dhe shprehive për të **dëgjuar**, **për të folur**, **për të lexuar** dhe **për të shkruar**. Këto janë në të njëjtën kohë edhe elementet kryesore përbërëse të mësimi të gjuhës amtare në klasën e dytë të shkollës fillore. Në këtë cikël, **të dëgjuarit** është një nga burimet më të rëndësishme për të fituar njohuritë, sepse ata nuk dinë të lexojnë ende. **Fëmijët e mësojnë gjuhën amtare me anën e të dëgjuarit**. Fjalori pasiv i nxënësve të kësaj moshe është shumë më i madh sesa fjalori aktiv, prandaj ata kuptojnë shumë më tepër sesa janë të aftë të shprehen gojarisht. Të dëgjuarit ka rol vendimtar në mësimin e shkrimit dhe të leximit. Përmes të dëgjuarit, ata do të mund të kuptojnë se fjalët përbëhen nga tinguj, çka është me rëndësi dhe do t'u shërbejë në procesin e të mësuarit të leximit dhe të shkrimit. Zhvillimi i të folurit do të jetë më i shpejtë, nëse tregojmë kujdes për zhvillimin e tij tek fëmijët. Për këtë arsye fëmijëve duhet t'u këndohet, t'u flitet dhe t'u lexohet sa më shumë. Gjithashtu, duhet t'u ofrohet mundësia, që edhe ata vetë të flasin sa më shumë. Zhvillimi i të folurit përfshin përvetësimin e rregullave fonologjike, semantike dhe morfosintaksore. Studimet

tregojnë se fjalori aktiv i fëmijëve të moshës 6-7 vjeçe nuk është shumë i pasur. Studiuesit japin shifrat nga 2500-2600 fjalë, të cilat fëmijët i përdorin aktivisht, ndërsa fjalori i tyre pasiv është shumë më i pasur.

Të lexuarit nuk është pasojë e zhvillimit biologjik të njeriut, por e atij kulturor dhe aftësia për të lexuar nuk ekziston si e lindur. Procesin e fitimit të kësaj shkathtësie, sigurisht, e vështirëson fakti, se lidhja midis tingullit dhe shenjës së tingullit nuk është natyrore, por e bërë me marrëveshje. Fazë kritike në procesin e të lexuarit është shndërrimi i shkronjave në tinguj. Tek mësimi i të lexuarit më i rëndësishëm është përvetësimi i lidhjeve midis shkronjave dhe tingujve, si edhe i rregullave të zëvendësimit të tyre (parimi alfabetik). **Të shkruarit** është proces i anasjelltë në raport me leximin. Kur mëson shkronjat dhe fiton ndjeshmërinë të dallojë tingujt, fëmija, jo vetëm që mund ta lexojë, por mundet edhe ta shkruajë një fjalë të caktuar. Në kuadër të këtij procesi, ai përcakton tingujt e fjalës, kujton shenjat grafike për to dhe i shkruan sipas renditjes së drejtë nga e majta në të djathtë. Të mësuarit e leximit e të shkrimit është një veprimtari e ndërlikuar, e cila bazohet në zhvillimin e të folurit. Të folurit dhe të shkruarit ndërthuren ndër vete. Me zhvillimin e komunikimit me të dëgjuar dhe me të folur, përmirësohet edhe të shkruarit.

Procesi i të mësuarit të lexim-shkrimit fillestar nënkupton dy operacione të rëndësishme: leximin fillestar dhe të shkruarit fillestar. Çfarë duhet të synojmë që të arrijmë gjatë këtyre operacioneve?

a. Të lexuarit fillestar

Rezultatet e të nxënit	
Nxënësi: - përdor njohuritë për tingujt, shkronjat dhe fjalët; - lexon dhe kupton tekste të thjeshta letrare dhe jo letrare, duke përdorur një sërë strategjish për të ndërtuar kuptimin; - identifikon pikat e forta si lexues, elementet që duhet të përmirësojë.	
Njohuritë	Aftësitë
- Shkronjat e alfabetit dhe tingujt. - Zanoret. - Bashkëtingëlloret. - Rrokja. - Fjala. - Tiparet dalluese të fjalisë (<i>fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund</i>). - Studim tekstesh letrare: përralla të shkurtra, fabula, tregime me figura, gjëgjëza, poezi të thjeshta.	Të lexuarit fillestar Nxënësi: - njeh tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe; - dallon rrokjen, fjalën dhe fjalinë; - përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe për të kuptuar fjalë të reja; - bashkon shkronjat dhe rrokjet për të lexuar fjalët; - ndan fjalët në rrokje; - dallon tiparet kryesore të fjalisë;

- Studim tekstesh jo letrare: kartolina, letra të thjeshta, rregulla të thjeshta praktike, orari i mësimëve, kalendar etj.	- lexon rrjedhshëm tekste të thjeshta, afërsisht 50-70 fjalë në minutë; - lexon me zë një tekst (afërsisht gjysmë faqeje) të palexuar më parë; - përdor ilustrimet për të kuptuar më mirë një tekst; - formon fjali me fjalët e reja në një tekst; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit në lidhje me përmbajtjen e tekstit; - lidh tekstin me përvojat e tij personale ose të të tjerëve; - shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes të folurit, shkrimit etj.; - identifikon personazhet kryesore dhe, në bashkëveprim me moshatarët, luan rolin e njërit prej personazheve; - shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar leximit të një teksti të thjeshtë në njërën nga format shprehëse: me gojë, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
---	--

b. Të shkruarit fillestar

Rezultatet e të nxënësit	
Nxënësi:	
- shkruan për të komunikuar idetë e veta tek të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.; - shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.	
Njohuritë	Aftësitë
- Shkrimi i shkronjave të gjuhës shqipe. - Shkrimi i fjalëve tre- deri katërrokëshe. - Shkrimi i fjalisë dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj. - Shkrimi i fjalisë, nisur nga një ilustrim. - Shkrimi i diktimeve (me ndihmën e mësuesit).	Nxënësi: - shkruan drejt shkronjat e gjuhës shqipe; - shkruan fjalë të thjeshta deri me tri rrokje; - vendos në formën e duhur fjalët në vendet që mungojnë;

- Shkrimi i një kartoline ose i një urimi sipas modeleve të dhëna. - Shkrimi i tregimeve të thjeshta, nisur nga disa ilustrime.	- shkruan dhe lidh kuptimshëm fjalët në struktura fjalish; - shkruan fjali të thjeshta sipas strukturës: kryefjalë, kallëzues, pjesë plotësuese; - shkruan fjali me të diktuar; - shkruan fjali me të kopjuar; - kopjon pjesë që kanë dialog, deri në 3-4 fjali; - shkruan duke plotësuar pjesë që mungojnë, të fjalës ose të fjalisë; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të ndryshme; - shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat që i ofrohen; - shkruan një kartolinë ose një urim, sipas modeleve të dhëna; - emërton sende dhe frymorë, i veçon mbi bazën e figurave apo të dëgjimit të emërtimeve të tyre; - shkruan me shkronjë të madhe në fillim të fjalive; - shkruan me shkronjë të madhe emrat e njerëzve; - shkruan në mënyrë intuitive drejt fjalët sipas modelit (një – shumë);
--	---

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - shkruan duke imituar modelin dhe me intuitë fjalët që tregojnë veprime që kryhen në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen; - shkruan fjalë që tregojnë cilësi; - ushtrohet për të shkruar drejt dhe pa gabime; - përdor shenjat e pikësimit, si: pikën (.) e pikëpyetjen (?); - përdor shkronjën e madhe në titujt e pjesëve dhe tek emrat e njerëzve; - respekton shkronjën e madhe në fillim fjalisë. |
|--|---|

Përdorimi i metodave për mësimin e lexim – shkrimit ka një rol të pazëvendësueshëm, ndihmon e hedh bazat shkencore, duke siguruar garanci për suksesin mes fitimit të aftësive.

Vendimet për procedurat dhe për metodat që përdor, mësuesi duhet t’ua përshtasë nxënësve, formimit dhe përvojave të tyre. Është e vështirë, madje e pamundur, që në një klasë të gjenden dy nxënës me aftësi, interesa apo nevoja të njëjta. Klasa, pra, nuk është kolektiv i individëve të njëjtë. Nxënësit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, secili ka kërkesa të veçanta, secili vepron, secili mëson ndryshe nga tjetri, prandaj secilit i duhet dhënë shansi të gjejë veten dhe ta zhvillojë personalitetin.

Hulumtimet në fushën e psikologjisë së edukimit kanë provuar se leximi dhe shkrimi, si procese psiko-fiziologjike kanë rrjedhë të kundërt, njëri është analitik (leximi) dhe tjetri sintetik (shkrimi). Bazuar në këtë kriter, në Konferencën e 12-të Ndërkombëtare për Mësimin Publik të UNESCO-s e të Byrosë Ndërkombëtare për Edukimin, u miratua klasifikimi i metodave të mëimit të lexim-shkrimit fillestar në këto grupe bazë:

1. Metodatat sintetike
2. Metodatat analitike
3. Metodatat analitike-sintetike
4. Metoda mikse